

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"C-2025" SHPK

Ortaku themelues si më poshtë:

Z. Klodian Bitri, shtetas shqiptar, i biri i Jorgjit, i datëlindjes 03.03.1981, lindur ne Lushnjë dhe banues në Tiranë, rruga "Rrapo Hekali", mbajtës i letërnjoftimit me nr personal I10303112Q,

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 28.01.2025, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "C-2025".

Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare "C-2025", ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "C-2025" SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga "e Kavajës", ZK. 8350, godine polifunkionale, me Nr. pasurie 6/8, kati i shtatë, Tiranë Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në fushën e pasurive të paluajtshme në shumë kategori si:

- Shit-blerje të pasurive të paluajtshme;
- Marrje dhe dhënie me qera të pasurive të paluajtshme;
- Menaxhim si dhe ndërmjetësim për shitje - blerje apo dhënie me qera të pronave të paluajtshme midis personave fizikë dhe juridikë, privatë apo publikë, si dhe nga shteti në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme.
- Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, vendase apo të huaja, për përmbushjen e objektit të aktivitetit të saj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.



NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "C-2025" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortaku/ët nuk përgjigjet/n për detyrimet e shoqërisë "C-2025" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "C-2025" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetëm Klodian Bitri i cili zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 100,000 (njëqind mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë do të jetë ortaku i vetëm Klodian Bitri.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortaku/ët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "C-2025" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

KLODIAN BITRI

Klodian Bitri